



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT KORÇE

VENDIM

NR 21 ,Dt. 10.06.2024

**PËR RISHIKIMIN E MARREVESHJES TË HUAPËRDORJES ME INSTITUCIONET E VENDOSURA NË KATIN PËRDHE TË GODINËS NË PRONËSI TË KQK.**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 77 gërma (e), me propozim të Kryesisë të Këshillit të Qarkut Korçë.

**V E N D O S I**

1. Të miratojë dhënie në huapërdorje në favor të institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë, Përmbartimit Shtetëror Korçë, Avokaturës së Shtetit Korçë, Zyrës së Përmbartimit Shtetëror Korçë, Institutit të Statistikave dhe Inspektoratit Shtetëror Shtëndetësor, të katit përdhe e cila është në pronësi të Këshillit të Qarkut Korçë me të dhënat, Pasuria Nr. 2/708-N1, Vol. 43 Fq. 81 në ZK 3564, me sipërfaqe 652.88 m<sup>2</sup>.
2. Periudha për të cilën kati përdhe i godinës i specifikuar në pikën 1 të Vendimit, do të lihet në huapërdorje institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë do të jetë 3 vjet nga përfundimi i afatit të kontratës aktuale (17.07.2024 -17.07.2027).
3. Ndarja e zyrave në huapërdorje e cila do të përbëhet në 5 blloqe duke u përshtatur dhe me institucionet të cilat do përfitojnë të specifikuar në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Autorizohen institucionet të cilat do marrin me huapërdorje këto ambiente të lidhin kontrata me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) dhe të kryejnë instalimet e nevojshme elektrike sipas nevojave të zyrave që do të kenë në huapërdorje.
5. Institucionet përfutuese kanë për detyrë mirëmbajtjen dhe restaurimin (në rast dëmtimi) të ambienteve të cilat do të marrin në huapërdorje dhe të ambienteve në përdorim të përbashkët.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Specialisti i nivelit të lartë për shërbimet, Burimet Njerëzore dhe Emergjencat civile dhe Kabineti i Kryetarit.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT**

Erjon Nexhipi

Miratuar me / 15 / Vota  
Vota Pro / 15 /  
Vota Kundër / 0 /  
Vota Abstenim / 0 /  
Zbardhur më datë /10/ 06/2024



Koncept. : R. Latollari  
Miratoi:Kësh. Juridik : M.Bylykbeshti  
Pranoi Sek i K Qarkut: B.Muço



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT KORÇE

RELACION

**“MBI DHËNIEN NË HUAPËRDORJE TË AMBIENTEVE TË NDODHURA NË KATIN PËRDHE TË GODINËS E CILA ËSHTË NË PRONËSI TË KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË”**

Pas shkëmbimit të ndërtesave respektive midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë bazuar në VKM Nr. 601 datë 31.08.2016, për rregullimin e situatës së krijuar faktike dhe ligjore nga ky shkëmbim, Këshilli i Qarkut Korçë me mirëkuptim ka rishikuar mundësinë për tu siguruar ambiente për ushtrimin e funksioneve të tyre edhe institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë dhe institucioneve të tjera. Në kushtet aktuale Këshilli i Qarkut Korçë i ka dhënë në huapërdorje institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë si dhe institucioneve të Përmbarrimit Shtetëror Korçë, Avokaturës së Shtetit, Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) dhe Institutit të Statistikave (INSTAT) me një afat 5-vjeçar, katin përdhe të godinës ku aktualisht ushtrojnë veprimtarinë këto institucione.

Në kushtet kur afati i kontratës së parë të huapërdorjes është në përfundim (kontratë huapërdorje Nr. 644 Prot. datë 17/07/2019) është sqyrtuar mundësia e lidhjes së një kontrate të re huapërdorje me institucionet respektive për një afat 3-vjeçar. pasuria nr. 2/708-N1, Vol. 43 Fq. 81 në ZK 8564, me sipërfaqe 652.88 m<sup>2</sup>. Ambientet e katit përdhe të godinës, pasuria nr. 2/708-N1, Vol. 43 Fq. 81 në ZK 8564, me sipërfaqe 652.88 m<sup>2</sup> do të ndahen në 5 blloqe dhe do të jepen me kontratë huapërdorje me një afat 3- vjeçar sipas skicës bashkëngjitur relacionit, nga ku:


- Zyrat me Nr. 1, 2, 3 dhe 4 do të jetë blloku 1.
- Zyrat me Nr. 5 dhe 6 do të jetë blloku 2.
- Zyrat me Nr. 7, 8, 9 dhe 10 do të jetë blloku 3.
- Zyrat me Nr. 11, 12, 13 dhe 14 do të jetë blloku 4.
- Zyra me Nr. 15 do të jetë blloku 5.

\* Tualetet dhe korridori janë ambjente të përbashkëta.

Konc. M. Bytykoshi



PRONA F KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË  
PASURIA 2/708-N1, ZK 8564, V 43, FQ 81  
PLANIMETRIA E KATIT PËRDHE



1. Zyrat 1, 2, 3 dhe 4 - Blloku 1
2. Zyrat 5 dhe 6 - Blloku 2
3. Zyra 7, 8, 9 dhe 10 - Blloku 3
4. Zyra 11, 12, 13 dhe 14 - Blloku 4
5. Zyra 15 Blloku 5

Tualetet dhe korridori ambjent i përbashkët